



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Kryesia e Kuvendit

P-002

Prishtinë, më 11 dhjetor 2014, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 11 DHJETOR 2014

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Jasmina Zhivković dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Donika Kada-Bujupi, Sasha Milosavljević dhe Valdete Bajrami.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Skender Berisha dhe Shaip Shabani;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj,

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë.

Kryetari në fillim i njoftoi anëtarët e Kryesisë për formimin e grupeve parlamentare të Kuvendit, si në vijim:

Grupi Parlamentar i PDK-së, me 35 deputetë, kryetar i grupit është caktuar deputeti Adem Grabovci.

Grupi Parlamentar i LDK-së, me 30 deputetë, kryetar i grupit është caktuar deputeti Ismet Beqiri.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, me 16 deputetë, i përfaqësuar nga deputeti Visar Ymeri.

Grupi Parlamentar i AAK-së, me 11 deputetë, kryetare e grupit është caktuar deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

Grupi Parlamentar i Listës serbe, me 10 deputetë, kryetar i grupit është caktuar deputeti Sasha Milosavljeviq.

Grupi Parlamentar “Nisma”, me 6 deputetë, i përfaqësuar nga deputetja Valdete Bajrami.

Grupi Parlamentar “6+”, me 6 deputetë, i përfaqësuar nga deputetja, Myfera Shinik.

Nënkryetarja e Kuvendit, Duda Balje, e njoftoi Kryesinë e Kuvendit se GP “6+” do të përfaqësohet në Kuvend me rotacion, në bazë të marrëveshjes që është arritur brenda këtij grupi parlamentar, duke filluar nga deputetja Myfera Shinik.

Kryetari gjithashtu i njoftoi anëtarët e Kryesisë me dorëheqjen e dy deputetëve: Gëzim Kelmendi dhe Margarita Kadriu-Ukelli, nga Grupi Parlamentar i PDK-PD-LB-PSHDK dhe PKK dhe se ata në të ardhmen do të veprojnë si deputetë të pavarur.

Kryetari, në vazhdim procedoi me këtë:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 8 dhjetor 2014

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 8 dhjetor 2014.

2. Propozimi për formimin e komisioneve parlamentare - numri dhe struktura e tyre

Kryetari i njoftoi nënkryetarët e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare me propozimin dhe kriteret për formimin e komisioneve parlamentare.

Ai tha se në Legjislaturën IV të Kuvendit kanë ekzistuar gjithsej 13 komisione parlamentare, ndërsa me Rregulloren e Kuvendit janë të parapara 16 komisione parlamentare.

Kryetari i propozoi Kryesisë që në këtë legjislaturë të formohen 14 komisione parlamentare.

Lidhur me propozimin për formimin e komisioneve parlamentare të Legjislaturës V, përkatësisht për emërimin, numrin dhe strukturën diskutuan: Jasmina Zhivković, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi, Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Adem Grabovci, Sasha Milosavljeviq, Valdete Bajrami, Glauk Konjufca dhe Duda Balje. Diskutimet e plota të tyre janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikën e lartpërmendur, mbi bazën e propozimit, bëri ndarjen e komisioneve parlamentare, si në vijim:

Grupi Parlamentar i PDK-së do t'i drejtojë këto komisione parlamentare:

1. Komisionin për Punë të Jashtme,
2. Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
3. Komisionin për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe
4. Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Grupi Parlamentar i LDK-së do t'i drejtojë këto komisione parlamentare:

1. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
2. Komisionin për Integritet Evropian,
3. Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe
4. Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do t'i drejtojë këto komisione parlamentare:

1. Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe
2. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Grupi Parlamentar i AAK-së do t'i drejtojë këto komisione parlamentare:

1. Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Grupi Parlamentar i Listës serbe do t'i drejtojë këto komisione parlamentare:

1. Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim.

Grupi Parlamentar “Nisma” do t'i drejtojë këto komisione parlamentare:

1. Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë.

Grupi Parlamentar “6+” do t'i drejtojë këto komisione parlamentare:

1. Komisionin për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor.

Kryesia, në fund, pasi bëri ndarjen e komisioneve parlamentare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi të hënën, më 15 dhjetor 2014, të mbajë seancën plenare, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite:

1. Miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare

Kryesia gjithashtu lidhur me pikën e lartpërmendur nxori këtë:

PËRFUNDIM

1. Seancës plenare i propozohet formimi i katërmëdhjetë (14) komisioneve parlamentare për Legjislaturën V.

2. Kërkohet nga grupet parlamentare që t'i dërgojnë emrat e deputetëve për kryetarë, zëvendëskryetarë dhe anëtarë në komisionet parlamentare, sipas përcaktimit në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, në Zyrën për Parashtresa E-209, deri të shtunën, më 13 dhjetor 2014, në orën 12:00.

3. Çështje vijuese:

1. Kërkesa e ish-kryetarit të Kuvendit, z. Jakup Krasniqi, për realizimin e përfutimeve të ish-zyrtarit të lartë

Kryesia e shtyu kërkesën e lartpërmendur për shqyrtim për mbledhjen e radhës të Kryesisë.

2. Kërkesa e Fondacionit SOS për mbështetje financiare fëmijëve të braktisur

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartpërmendur, mori këtë:

VENDIM

1. Miratohet kërkesa e Fondacionit SOS fshatrat e fëmijëve për mbështetje financiare në shumën prej 1 000 (njëmijë) euro për realizimin e programeve për fëmijët e braktisur në Kosovë.

2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere.

Pika shtesë:

1. Njoftimi i presidentes së Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, për t'iu adresuar Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me njoftimin e lartpërmendur, vendosi që Kuvendi të enjten, më 18 dhjetor 2014, të mbajë seancën plenare, në orën 10:00 me këtë:

Rend dite

1. Adresimi i presidentes së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale